

20203024120

## LIGJ PËR SIGURI TË PËRGJITHSHME TË PRODHIMEVE (\*)

### Kapitulli 1

#### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Lënda dhe qëllimi i ligjit

###### Neni 1

(1) Me këtë ligj rregullohet siguria e përgjithshme e prodhimeve të cilat plasohen në treg, kriteret për vlerësim të përputhshmërisë së prodhimeve me kërkesat e përgjithshme të sigurisë, obligimet e prodhuesit dhe të distributorit, kushtet për informim dhe shkëmbim të informatave në lidhje me rreziqet që dalin nga prodhimi për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve dhe të shfrytëzuesve të tjerë, si dhe kryerjen e mbikëqyrjes.

(2) Qëllimi i këtij ligji është të sigurohet se prodhimet të cilët plasohen në treg janë të sigurta.

##### Zbatimi

###### Neni 2

(1) Ky ligj zbatohet në të gjitha prodhimet të cilat në kuptim të këtij ligji konsiderohen prodhim, përveç për prodhime për të cilat me rregulla të posaçme janë përcaktuar kërkesat për sigurinë e tyre.

(2) Ky ligj zbatohet edhe në rreziqet dhe kategoritë e rreziqeve të cilat prodhimi mund t'i bart, por që nuk janë të përfshira me rregulla të posaçme me të cilat përcaktohen kërkesat për siguri të prodhimeve.

(3) Nëse me rregull të posaçme me të cilën përcaktohen kërkesat për sigurinë e prodhimeve, nuk rregullohen çështjet lidhur me obligimet e prodhuesit dhe të distributorit, obligimin për informim dhe shkëmbim të informatave në lidhje me prodhimin, si dhe çështje që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen, me këtë rast, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji.

##### Përgjegjësia për dëmin

###### Neni 3

Përbushja e detyrimeve të prodhuesit të përcaktuara me këtë ligj nuk e përjashton përgjegjësinë e prodhuesit për dëmin e shkaktuar nga prodhimi, përkatësisht nga prodhimi me mangësi në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore.

##### Kuptimi i nocioneve dhe i shprehjeve të caktuara

###### Neni 4

Nocionet dhe shprehjet e veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin në vijim:

---

(\*) Me këtë ligj bëhet harmonizimi me Direktivën 2001/95/KE për siguri të përgjithshme të prodhimeve, CELEX numër 32001L0095 dhe me Direktivën e 87/357/KEE për harmonizim të ligjeve të vendeve anëtare që ka të bëjë me prodhimet që si të ndryshme nga ato që duhet t'i paraqesin, e rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, CELEX numër 31987L03572001/95/KE për siguri të përgjithshme të prodhimeve, CELEX numër 32001L0095 dhe me Direktivën e 87/357/KEE për harmonizim të ligjeve të vendeve anëtare që ka të bëjë me prodhimet që si të ndryshme nga ato që duhet t'i paraqesin, e rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, CELEX numër 31987L0357

(a) "konsumator" është personi i përkufizuar si konsumator në rregullat për mbrojtje të konsumatorëve

(b) "prodhim" është secili prodhim, duke përfshirë edhe prodhimin në kontekst të dhënies së shërbimeve, i cili i dedikohet konsumatorëve ose me gjasë, sipas kushteve të parapara në mënyrë të arsyeshme, që do të përdoret nga konsumatorët edhe nëse nuk është i dedikuar për to dhe i cili është blerë ose është bërë i kapshëm, me ose pa kompensim, në kuadër të veprimtarisë ekonomike, pa marrë parasysh nëse është i ri, i përdorur ose i riparuar, përveç prodhimit të përdorur i cili porositet si antikuitet ose prodhim i cili duhet të përmirësohet ose riparohet para se të përdoret, me kusht që furnizuesi për atë qartë ta informojë personin që e furnizon me atë prodhim;

(c) "prodhim i sigurt" është prodhim i cili, në kushte normale ose në kushte të parapara të arsyeshme për përdorim, përfshi edhe afatin e tij të kohëzgjatjes dhe i cili, atëherë kur është i ndryshueshëm, me kërkesat për vënien në përdorim, instalimi dhe mirëmbajtje, nuk paraqet kurrfarë rreziku ose paraqet vetëm rrezik minimal me përdorimin e prodhimit dhe i cili konsiderohet se është i pranueshëm dhe i magazinuar me nivel të lartë të mbrojtjes për sigurinë dhe shëndetin e njerëzve, duke marrë parasysh posaçërisht:

- karakteristikat e prodhimit duke përfshirë përbërjen e tij, paketimin, instruksionin për përpilim dhe, kur është i ndryshueshëm, instruksione për instalim dhe mirëmbajtje,

- efektet mbi prodhimet tjera, atëherë kur është arsyeshëm e parashikueshme se i njëjti do të përdoret së bashku me prodhimet tjera,

- paraqitjen e prodhimit, shënimin e tij, çfarë do paralajmërime dhe udhëzime për përdorim dhe hedhjen dhe/ose asgjësimin, dhe çfarë do lloj shenja ose informata në lidhje me prodhimin dhe

- kategoritë e konsumatorëve, posaçërisht fëmijët dhe personat e moshuar të cilët janë të ekspozuar në rrezik gjatë përdorimit të prodhimit;

(g) "prodhim i rrezikshëm" është prodhimi i cili nuk është i sigurt në kuptim të domethënies së përcaktuar me këtë ligj, me ç'rast mundësia të arrihen nivele më të larta të sigurisë ose arritshmërisë së prodhimeve tjera të cilët paraqesin shkallë më të ulët të rrezikut nuk do të paraqes bazë prodhimi të konsiderohet i rrezikshëm;

(d) "Prodhim mashtrues" është prodhimi i cili e rrezikon shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve kështu që në pamjen e tij, formën, madhësinë, ngjyrën, aromën, paketimin, përkatësisht ambalazhin, shenjën, sasinë ose mënyrë tjetër ngjanë në prodhim ushqimor, ndërsa nuk është prodhim ushqimor, kështu që ekziston një gjasë e konsiderueshme se konsumatorët, e posaçërisht fëmijët, do ta përdorin si prodhim ushqimor që do të duhet të paraqet rrezik nga mbytja, helmimi, shpërthimi ose obstrukcioni i traktit digjestiv ose rrezik tjetër për shëndetin e tyre ose jetën;

(gj) "rrezik serioz" është çdo rrezik serioz, duke përfshirë edhe atë efektet e të cilëve nuk janë të drejtpërdrejta dhe të cilët kërkojnë intervenim të shpejtë organet kompetente të administratës shtetërore;

(e) "prodhues" është:

- personi i cili e përpunon prodhimin, kur i njëjti ka seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ose në Bashkimin evropian, si dhe i cili ka qenë person juridik ose fizik i cili paraqitet si prodhues kështu që në prodhimet e vë emrin e tij, shenjën mbrojtëse ose shenjë tjetër për dallim, ose person i cili e riparon prodhimin,

- përfaqësuesi i prodhuesit, kur prodhuesi nuk ka seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në Bashkimin Evropian ose, nëse prodhuesi nuk ka përfaqësues në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në Bashkimin Evropian, importues i prodhimit dhe

- person tjetër të cilët në kuadër të veprimtarisë së vet ekonomike merr pjesë në zinxhirin e furnizimit, nëse aktiviteti i tij mund të ndikojë në sigurinë e prodhimeve.

(zh) "distributor" është personi juridik ose fizik i cili në kuadër të veprimtarisë së vet është përfshirë në zinxhirin e furnizimit dhe aktiviteti i të cilit nuk ndikon në sigurinë e prodhimit;

(z) "kthimi i prodhimit" është masë e cila ka për qëllim të kthehet prodhimi i rrezikshëm me të cilin prodhuesi ose distributori i ka furnizuar ose e ka bërë të arritshëm për konsumatorët;

(x) "tërheqja e prodhimit" është masë e cila ka për qëllim parandalimin e distribuimit, shfaqjen ose ofertën e prodhimit që është e rrezikshme për konsumatorin;

(i) "organet e mbikëqyrjes së tregut" janë inspektorati Shtetëror i Tregut, Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror i Punës, Inspektorati Shtetëror për Inspektim Teknik, Inspektorati Shtetëror i Ambientit Jetësor dhe organet tjera të administratës shtetërore ose inspektorë që kryejnë mbikëqyrjen e tregut në pajtim me ligjin, si dhe organe tjera dhe organizata dhe trupa të pavarur rregullator që kryejnë mbikëqyrje të tregut;

(j) "qasja në treg" është çdo furnizim i prodhimit për distribuim, konsum ose për përdorimin e tregut në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të tregut të Bashkimit Evropian, përmes veprimtarisë me ose pa pagesë të kompensimit dhe

(k) "plasimi i tregut" është aktivitet me të cilin prodhimi për herë të parë bëhet i arritshëm në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe/ose i tregut të Bashkimit Evropian;

## Kapitulli 2

### KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E PËRPUTHSHMËRISË SË PRODHIMIT ME KËRKESAT E PËRGJITHSHME TË SIGURISË

#### Kërkesë e përgjithshme e sigurisë

##### Neni 5

(1) Prodhuesit janë të detyruar në treg të plasojnë vetëm prodhime të sigurta.

(2) Prodhimi konsiderohet i sigurt, në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni, kur, nëse nuk ekzistojnë rregulla për siguri të atij prodhimi, i njëjti përputhet me rregullat me të cilët përcaktohen kërkesat shëndetësore dhe të sigurisë të cilët prodhimi doemos duhet t'i plotësojë që të plasohet në treg.

(3) Prodhimi supozohet se është i sigurt, në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni, kur nëse nuk ka rregulla adekuate teknike, duke marrë parasysh standardet, përputhet me standardet nacionale me të cilat ndërmerren standardet evropiane të miratuara për shkak të përmbushjes së kërkesave të përgjithshme për siguri të prodhimeve.

(4) Listën e standardeve nga paragrafi (3) të këtij neni e përcakton ministri i Ekonomisë dhe botohet në "Gazetën Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut".

#### Kriteret tjera për përcaktimin e përputhshmërisë

##### Neni 6

Nëse nuk ekzistojnë rregullat, përkatësisht standardet nga neni 5 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji, përputhshmëria e prodhimit me kërkesat e përgjithshme të sigurisë do të vlerësohet në bazë të këtyre elementeve, kur ato ekzistojnë:

1. standarde vullnetare nacionale të cilët merren nga standardet evropiane, kurse të cilët nuk janë të përfshira me listën e standardeve nga neni 5 të këtij ligji;

2. standardet nacionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

3. rregulla e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me të cilët ndërmerren rekomandimet e Komisionit Evropian dhe me të cilët jepet drejtim për vlerësim të sigurisë së prodhimit, përkatësisht rekomandimet e Komisionit Evropian, në pajtim me nenin 16 të këtij ligji;

4. kodet e praktikave të mira në sferën e sigurisë së prodhimeve të cilët janë në fuqi me sektorin adekuat;

5. gjendja e teknikës dhe teknologjisë dhe

6. pritje të arsyeshme për nivelin e sigurisë që e kanë konsumatorët.

### **Ndalimi për prodhime mashtruese**

#### Neni 7

Ndalohet prodhimi, importi, eksporti ose plasmani në treg i prodhimeve mashtruese.

### **Klauzola mbrojtëse**

#### Neni 8

Organet e mbikëqyrjes së tregut, nëse në bazë të dëshmive përcaktojnë që prodhimi, megjithëse i plotëson kërkesat e sigurisë në përputhje me këtë ligj, paraqet prodhim të rrezikshëm, ka të drejtë ta ndalojë plasimin në treg, përkatësisht të përcaktojë tërheqjen dhe / ose kthimin e prodhimit.

### **Kapitulli 3**

## **DETYRIMET E PRODHUESIT DHE DISTRIBUTORIT**

### **Obligimet e prodhuesit**

#### Neni 9

(1) Prodhuesit në kuadër të kryerjes së veprimtarisë së tyre, janë të detyruar t'u sigurojnë konsumatorëve të gjithë informacionin e duhur që u mundëson atyre të vlerësojnë rreziqet e prodhimit gjatë periudhës normale ose të parashikueshme të përdorimit dhe të marrin masa paraprake për rreziqet e prodhimit edhe aty ku rreziqet e tilla nuk janë menjëherë të dukshme pa paralajmërimin e duhur.

(2) Dhënia e informatave nga paragrafi (1) i këtij neni nuk e liron prodhuesin nga përgjegjësia për harmonizim me kërkesat e tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve.

(3) Prodhuesi është i detyruar, në varësi të cilësive të prodhimit, dhe në kuadër të veprimtarisë së tij, të marrë masa që do t'i mundësojnë vlerësimin ose përcaktimin e rrezikut, në mënyrë që t'i paralajmërojë në mënyrë adekuate konsumatorët ose të ndërmarrë veprime të caktuara për të eliminuar ose zvogëluar dhe rrezikun, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, për të shmangur rreziqe të tilla, kthimin në treg ose tërheqjen e prodhimit nga konsumatorët.

(4) Masat nga paragrafi (3) të këtij neni, përfshijnë, posaçërisht:

- shënimi i identitetit të prodhuesit dhe sigurimi i informatave tjera për prodhuesin dhe për prodhimin ose, ku është e mundur, seria e prodhimeve në të cilat ai bën pjesë, në prodhimin ose ambalazhin e tij, përveç kur është e arsyeshme informatat e tilla të mos jepen dhe

- nëse është nevojshme, zbatimi i testeve të mostrave nga prodhimet e plasuar, hulumtimit dhe, nëse është e nevojshme, mbajtja e regjistrit të ankesave dhe njoftim të rregullt të distributorëve për monitoringun e tij.

(5) Masat nga paragrafi (4) i këtij neni, prodhuesit i ndërmarrin sipas iniciativës së vet ose me kërkesë të organeve kompetente.

(6) Prodhuesi masat e lidhura me prodhimin ose tërheqjen e prodhimit e ndërmerr sipas iniciativës personale ose me kërkesë të organit kompetent. Kthimet e prodhimeve merren si një mundësi e fundit, kur masa të tjera nuk do të jenë të mjaftueshme për të eliminuar ose zvogëluar

rrezikun, dhe në rastet kur prodhuesit e konsiderojnë të nevojshme ose kur ata janë të detyruar ta bëjnë këtë si një masë e marrë nga organet kompetente. Kthimi i prodhimit mund të zbatohet në kuadër të rregullave të përvojave më të mira për prodhime të caktuara.

### **Obligimet e distributorit**

#### **Neni 10**

(1) Distributori është i detyruar, në kuadër të veprimtarisë që e kryen, të veprojë me kujdes adekuat profesional me qëllim të sigurohet përputhshmëria e prodhimit me kërkesa të ndryshueshme për siguri.

(2) Distributeri nuk guxon të plasojë prodhime për të cilat di ose do të duhet të dijë, në bazë të informatave që i ka dhe në pajtim me profesionalizmin e tij, se nuk është në pajtim me kërkesat e sigurisë.

(3) Distributori në kuadër të aktiviteteve të veta është i detyruar të marrë pjesë në ndjekjen e sigurisë së prodhimeve të plasuara në treg përmes:

- dorëzimit të informatave për rreziqet e prodhimit;
- ruajtjen dhe dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm të nevojshëm për zbulimin e prejardhjes së prodhimit dhe
- ndërmarrjes së masave që do t'i mundësojnë në mënyrë efektive të bashkëpunojnë në zbatimin e masave dhe aktiviteteve nga ana e prodhuesve dhe organeve kompetente me të cilat do të parandalohen rreziqet.

### **Obligimet e përbashkëta të prodhuesit dhe distributorit për njoftim**

#### **Neni 11**

(1) Kur prodhuesit dhe distributorët e dinë ose duhet të dinë, në bazë të informatave që i kanë se prodhimi që e ka plasuar në treg paraqet rrezik për konsumatorin, ndërsa ai rrezik është jokompatibil me kërkesat e përgjithshme të sigurisë, janë të detyruar në Ministrinë e Ekonomisë - Inspektoratin Shtetëror të Tregut të dorëzojnë njoftim që përmban së paku:

- informata që do të mundësojnë identifikim preciz të prodhimit ose serisë së prodhimeve të cilave u referohet;
- përshkrim të plotë të rrezikut që prodhimi e paraqet;
- të gjitha informatat e arritshme relevante për ndjekjen e prodhimit dhe përshkrimi i veprimeve të ndërmarra për parandalimin e rrezikut për konsumatorët.

(2) Mënyra e njoftimit, si dhe mënyra, kriteret dhe metodat e vlerësimit të rrezikut nga ana e prodhuesve dhe distributorëve dhe formën dhe përmbajtjen e formularit për njoftim nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri i Ekonomisë.

(3) Ministri i Ekonomisë do ta informojë Komisionin Evropian për njoftimin nga paragrafi (1) të këtij neni në rastet kur do të përcaktohet se rreziku mund të ndikojë në vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

### **Obligimet e përbashkëta të prodhuesit dhe distributorit për bashkëpunim me organet inspektuese**

#### **Neni 12**

(1) Prodhuesit dhe distributorët, në kuadër të veprimtarisë së tyre, janë të detyruar të bashkëpunojnë, me kërkesë të organeve kompetente për mbikëqyrje të tregut, në të gjitha veprimet që ndërmerren me qëllim që të evitohen rreziqet të cilët dalin nga prodhimet të cilët i plasojnë ose veçse i kanë plasuar në treg.

(2) Prodhuesit dhe distributorët të cilët nuk do të veprojnë në pajtim me kërkesën e organeve kompetente për mbikëqyrje të tregut përgjigjen në pajtim me nenin 18 të këtij ligji.

## Кapитulli 4

### INFORMIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMATAVE

#### Transparenca e të dhënave

##### Neni 13

(1) Të dhënat në dispozicion të organeve kompetente në lidhje me rreziqet për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve që dalin nga prodhimet janë publike, në pajtim me kërkesat e transparencës.

(2) Organet kompetente janë të detyruar të mundësojnë qasje te informatat me të cilat në mënyrë të detajuar përshkruhet prodhimi, natyra e rrezikut që del prej tij dhe masat që ndërmerren në lidhje me atë prodhim.

(3) Me përjashtim të paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, nuk janë publike të dhënat të cilat në pajtim me rregullat për qasje te informatat nuk mund të shpallen, si dhe informatat që janë të nevojshme për marrjen e veprimeve të vëzhguesve të tregut dhe veprimeve hetuese.

(4) Organet kompetente janë të detyruar të ndërmarrin veprime me të cilat do të parandalojnë qasje te informatat që paraqesin fshehtësi afariste kur për atë ka interes të arsyeshëm.

(5) Fshehtësi afariste, në kuptim të këtij ligji, nuk mund të jenë informatat të cilat i përkasin cilësive të sigurisë të prodhuesve të cilët duhet të jetë të kapshme për publikun, për atë kur e kërkojnë rrethanat e rastit të mbrohet shëndeti dhe siguria e konsumatorëve dhe të mbrohet interesi publik.

(6) Ruajtja e sekreteve afariste nuk guxon ta pengojë bartjen e informatave ndërmjet organeve kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe ndërmjet organeve kompetente të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Komisionit Evropian. Organet kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut të cilët kanë marrë informatë të shënuara si sekret afarist janë të detyruar të sigurojnë mbrojtje të saj në pajtim me ligjin.

#### Shkëmbimi i informatave

##### Neni 14

(1) Për njoftim të shpejtë dhe alarmim ndërmjet organeve për mbikëqyrje të tregut në Republikën e Maqedonisë së Veriut për masat dhe aktivitetet nga neni 18 dhe neni 32 të këtij ligji të cilat ndërmerren në lidhje me rreziqet që dalin nga prodhimi i rrezikshëm për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve vendoset sistemi i shkëmbimit të shpejtë i informatave.

(2) Organet për mbikëqyrje të tregut e shfrytëzojnë sistemin e shkëmbimit të shpejtë të informatave në lidhje me rrezikun serioz, si dhe me rreziqe tjera të cilat për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve që dalin nga prodhimi i rrezikshëm ose nga prodhimi mashtrues.

- do të urdhërojë masë të kthimit ose tërheqjes së prodhimit që paraqet rrezik serioz ose është prodhim mashtrues;

- do të ndërmarrë ose do të rekomandojë, përkatësisht do të koordinojë ose organizojë aktivitete adekuate të prodhuesit ose distributorit në lidhje me rrezikun dhe

- është i njoftuar me qëllimin e prodhuesit ose distributorit për zbatimin e aktiviteteve të tyre të cilët kanë për qëllim mënjanimin ose zvogëlimin e rrezikut, në nivel të pranuar, që prodhimi i plasuar në treg e paraqet.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të ministrit të Ekonomisë, për së afërmi do ta rregullojë mënyrën e vendosjes dhe punën e sistemit për shkëmbim të shpejtë të informatave.

(4) Organi kompetent për bashkimin dhe distribuimin e informatave të paragrafit (1) të këtij neni është Ministria e Ekonomisë-Inspektorati Shtetëror i Tregut.

## **Njoftimi i Komisionit Evropian**

### Neni 15

(1) Ministria e Ekonomisë - Inspektorati shtetëror i tregut është i detyruar për masat e ndërmarra nga neni 14 paragrafi (2) i këtij ligji, ta njoftojë Komisionin Evropian dhe pastaj t'i shënojë arsyet e masave të miratuara.

(2) Informimi për prodhimet të cilët paraqesin rrezik serioz zbatohet përmes sistemit për informim të shpejtë për prodhimet të cilët paraqesin rrezik serioz (në tekstin e mëtejshëm: RAPEX).

(3) Pika kontaktuese e sistemit RAPEX në Republikën e Maqedonisë së Veriut është Ministria e Ekonomisë -Inspektorati Shtetëror i Tregut.

(4) Ministria e Ekonomisë - Inspektorati Shtetëror i Tregut është i detyruar ta njoftojë Komisionin Evropian për secilin ndryshim ose ndërprerjen e masave.

(5) Kur Ministria e Ekonomisë - Inspektorati Shtetëror i Tregut vlerëson se efektet nga rreziqet e përcaktuara nuk kanë ose nuk mund të kenë shtrirje jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e njofton Komisionin Evropian për masat e marra, nëse ato përmbajnë informata të cilat do të jenë në interes të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian në pikëpamje të sigurisë së prodhimeve dhe posaçërisht, nëse këto masa janë miratuar si përgjigje të rrezikut të ri i cili nuk ka qenë i përfshirë në njoftime tjera.

## **Zbatimi i vendimeve të Komisionit Evropian**

### Neni 16

(1) Kur për zbatimin e vendimeve të Komisionit Evropian për të cilin ndalohet ose kufizohet plasimi në treg dhe burimi i prodhimit të caktuar ose një grup prodhimesh të cilat paraqesin rrezik serioz për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut më së voni në afat prej 20 ditësh nga dita e shpalljes së vendimit të Komisionit Evropian ose në afatin e përcaktuar me vendimin do të miratojë dispozitë për ndalim ose kufizim të plasimit të prodhimit.

(2) Me dispozitën nga paragrafi (1) i këtij neni më afërsisht do të rregullohet veprimi i prodhuesit dhe i shpërndarësit në lidhje me zbatimin e vendimit të Komisionit Evropian.

### Kreu 5

## **МБИКËQYRJA**

### **Kompetenca për mbikëqyrje dhe mbikëqyrje inspektuese**

### Neni 17

(1) Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji kryen Ministria e Ekonomisë.

(2) Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji kryen Inspektorati Shtetëror i Tregut nëpërmjet inspektorëve shtetërorë të tregut (në tekstin e mëtejshëm: inspektorë kompetentë).

(3) Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji kryejnë edhe organe tjera për mbikëqyrje të tregut, e në kuadër të lëndës së tyre të mbikëqyrjes të rregulluar me rregulla të veçanta (në tekstin e mëtejshëm: inspektorë kompetentë ose persona të autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes).

## **Masa të organeve për mbikëqyrje të tregut**

### **Neni 18**

(1) Organet për mbikëqyrje të tregut gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, përveç masave në pajtim me nenin 9 paragrafët (4), (5) dhe (6), nenin 10 paragrafi (3) dhe nenin 12 paragrafi (1) të këtij ligji, me aktvendim, mund t'i ndër marrë dhe shqiptojë masat si vijojnë:

1. Për prodhim mundet:

- të organizojë, bile edhe pasi prodhimi është plasuar në treg si i sigurt, kontrole adekuate të karakteristikave të tij të sigurisë, në vëllim adekuat, deri në fazën e fundit të përdorimit ose konsumimit;

- t'i kërkojë të gjitha informatat e domosdoshme nga personat e përfshirë në zinxhirin e furnizimit dhe

të marrë mostra nga prodhimet dhe t'i nënshtrojë në kontroll të sigurisë;

2. Për prodhimin që mund të paraqesë rrezik në kushte të caktuara mundet:

- të kërkojë të jetë i shënuar me paralajmërime adekuate, të qarta dhe lehtë të kuptueshme, në gjuhën zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për rreziqet të cilat mund t'i paraqesë dhe  
- plasimi i tij në treg të jetë i kushtëzuar me plotësimin e kërkesave paraprake me qëllim që prodhimi të jetë i sigurt;

3. Për prodhim që mund të paraqesë rrezik për persona të caktuar mund të urdhërojë që personat në kohë dhe në mënyrë adekuate të paralajmërohen për rrezikun, duke përfshirë edhe shpalljen e paralajmërimeve të veçanta;

4. Për prodhim i cili mund të jetë i rrezikshëm, përkohësisht ta ndalojë plasimin e tij, ofertat për plasim ose ekspozimin e tij edhe atë për periudhën e nevojshme për zbatimin e vlerësimeve dhe kontroleve të ndryshme të sigurisë;

5. Për prodhim të rrezikshëm ta ndalojë plasimin e tij në treg dhe të vendosë masa kontrolluese të nevojshme që të sigurohet se ndalimi zbatohet dhe

6. Për prodhim të rrezikshëm i cili tanimë është në treg mundet:

- të urdhërojë ose organizojë tërheqjen e tij konkrete dhe të drejtpërdrejtë dhe t'i paralajmërojë konsumatorët për rreziqet të cilat ai i shkakton dhe

- të urdhërojë ose koordinojë ose, nëse është e nevojshme, së bashku me prodhuesit dhe shpërndarësit, të organizojë kthim të prodhimit nga konsumatorët dhe shkatërrimin e tij në kushte adekuate.

## **Aktvendimi i inspektorëve kompetentë**

### **Neni 19**

(1) Inspektorët kompetentë janë të detyruar t'i sugjerojnë tregtarit për masën që do ta shqiptojnë dhe me aktvendim ta përcaktojnë mënyrën e realizimit të tij.

(2) Me aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori kompetent e përcakton afatin në të cilin merret masa gjatë së cilës ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se njëzet e katër orë as më i gjatë se tetë ditë.

(3) Nëse subjekti i mbikëqyrjes nuk vepron sipas urdhrorit të inspektorit kompetent nga paragrafi (2) i këtij neni, inspektori kompetent me aktvendim shqipton ndalim të përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë deri në tridhjetë ditë pune.

(4) Masën e kthimit të prodhimit nga neni 18 paragrafi (1) pika 6 nënparagrafi 2 të këtij ligji, inspektori kompetent e shqipton si masë të fundit, nëse të gjithë masat tjera nga ky ligj që i marrin prodhuesi dhe shpërndarësi, në mënyrë të pavarur ose me urdhëresë të inspektorit kompetent nuk janë të mjaftueshme ose nuk i japin rezultatet e pritura.

(5) Para marrjes së masave për tërheqjen ose kthimin e prodhimit nga neni 18, paragrafi (1), pikat 4, 5 dhe 6 të këtij ligji, organet inspektuese kompetente janë të detyrueshme t'i nxisin prodhuesit dhe shpërndarësit që në mënyrë të pavarur t'i zbatojnë këto masa, duke përfshirë edhe ku është adekuate nëpërmjet miratimit të kodekseve për praktikë më të mirë.

## **Procedura për mbikëqyrje inspektuese**

### **Neni 20**

- (1) Inspektorët kompetentë e kryejnë mbikëqyrjen inspektuese me detyrë zyrtare.
- (2) Inspektorët kompetentë janë të autorizuar të kryejnë mbikëqyrje inspektuese dhe sipas fletëparaqitjes nga konsumatori ose personi tjetër i interesuar, me atë që kjo ka vetëm veprim të iniciativës për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese.
- (3) Inspektorati kompetent është i detyruar ta njoftojë parashtruesin e fletëparaqitjes nëse është kryer mbikëqyrje inspektuese në bazë të fletëparaqitjeve dhe cilat masa janë ndërmarrë.
- (4) Mbikëqyrja inspektuese fillon me ndërmarrjen e veprimit të parë nga inspektori kompetent.
- (5) Inspektori kompetent për të gjitha veprimet në procedurën për mbikëqyrjen inspektuese që janë me rëndësi për përcaktimin e gjendjes faktike përpilon procesverbal.
- (6) Kur do të përcaktojnë shkeljen e dispozitave të këtij ligji ose të rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, inspektori kompetent miraton aktvendim në pajtim me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tij, e në afat prej pesë ditësh pune nga fillimi ose nga përfundimi i procedurës për mbikëqyrje inspektuese.

## **Subjekte të cilave mund t'u shqiptohen masat inspektuese**

### **Neni 21**

- Organi inspektues kompetent do t'i shqiptojë masat e këtij ligji në mënyrë adekuate ndaj:
- prodhuesit,
  - shpërndarësit në kuadër të veprimeve të tyre, posaçërisht atij shpërndarësi i cili kryen ose e ka kryer shkallën e parë të shpërndarjes në treg dhe
  - persona tjerë juridikë dhe fizikë kur kjo është e nevojshme që të sigurohet bashkëpunimi i tyre në veprimet për mënjanimin dhe pengimin e rreziqeve të cilat dalin nga prodhimi.

## **Deklarimi i subjekteve**

### **Neni 22**

- (1) Organi inspektues kompetent para shqiptimit të masave nga neni 18 i këtij ligji, subjekteve nga neni 21 i këtij ligji do t'u dorëzojë procesverbal për mbikëqyrjen e zbatuar për të cilin subjektet do të mund të deklarohen.
- (2) Nëse shqiptimi i masave është urgjent për shkak të ekzistimit të rrezikut serioz për jetën dhe shëndetin e shfrytëzuesve, organi inspektues kompetent të drejtën e deklaramit do ta mundësojë pas miratimit të masës.

## **Ankesa kundër aktvendimit për shqiptimin e masës**

### **Neni 23**

- (1) Kundër aktvendimit me të cilin është shqiptuar masa nga organet kompetente për mbikëqyrje të tregut mund të deklarohet ankesë në afat prej tetë ditësh te Komisioni Shtetërorë për Vendimmarrje në shkallë të dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse. Të dy pikat në fund të kësaj dispozite janë rezultat i spastrimit të saj në pajtim me nenin 1 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për siguri të prodhimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër.
- (2) Ankesa kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk e prolongon zbatimin e tij.

## **Shpenzime të procedurës për shqiptimin e masës**

### **Neni 24**

Shpenzimet të cilat do të ndodhin në procedurën për mbikëqyrje inspektuese janë në barrë të prodhuesit dhe/ose shpërndarësit nëse përcaktohet se prodhimi nuk është i sigurt.

## **Proporcionaliteti**

### **Neni 25**

Kur inspektori kompetent i ndërmerr masat e përcaktuara me nenin 18 paragrafi (1) të këtij ligji, e veçanërisht ato nga pikat 4, 5 dhe 6, vepron me vëmendje adekuate në proporcion me rrezikun.

## **Parandalimi**

### **Neni 26**

Inspektori kompetent mund t'i ndërmarrë masat nga neni 18 paragrafi (1) i këtij ligji, e në rast kur nuk ekziston dëshmi shkencore përfundimtare në lidhje me rrezikun të cilin prodhimi mund ta paraqesë, pa marrë parasysh nëse pasojat e atij rreziku janë të drejtpërdrejta ose prolonguese, por ekziston rezultati fillestar, edhe pse jo i vërtetuar deri në fund nga hulumtimi shkencor i cili sugjeron në seriozitetin e rrezikut dhe pasojave të mundshme për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve.

## **Bashkëpunimi në zbatimin e mbikëqyrjes**

### **Neni 27**

(1) Me qëllim që të sigurohet mbikëqyrje efikase në treg, i cili ka për qëllim të garantojë nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së konsumatorit, organet për mbikëqyrje të tregut bashkëpunojnë në mënyrë të ndërsjellë.

(2) Organet për mbikëqyrje të tregut bashkëpunojnë edhe me organet për mbikëqyrjen e tregut të vendeve-anëtare të Bashkimit Evropian.

(3) Gjatë zbatimit të mbikëqyrjes, organet e mbikëqyrjes së tregut, përveç autorizimeve që kanë në bazë të këtij ligji dhe rregullave me të cilat rregullohet kompetenca e tyre, do të jenë kompetente për të ndërmarrë aktivitetet si vijojnë:

- vendosje, azhurnim periodik dhe zbatim i programeve sektoriale të mbikëqyrjes sipas kategorive të prodhimeve ose rreziqeve dhe monitorim i aktiviteteve të mbikëqyrjes, konstatimeve dhe rezultateve;

- ndjekje dhe azhurnim i njohurive shkencore dhe teknike për sigurinë e prodhimeve dhe

- rishikim dhe vlerësim periodik i funksionimit të aktiviteteve të kontrollit dhe efikasitetit të tyre dhe nëse është e nevojshme, rishikim i qasjes mbikëqyrëse dhe organizatës së themeluar.

(4) Organet për mbikëqyrje të tregut së bashku bashkëpunojnë në pajtim me Ligjin për mbikëqyrje të tregut.

## **Veprim i organit doganor**

### **Neni 28**

Organi doganor nuk do të lejojë import ose eksport të prodhimit për të cilin me rregull të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me të cilën merret vendim i Komisionit Evropian, ndalohet ose kufizohet plasimi në treg dhe eksporti i prodhimit të caktuar ose grupit të prodhimeve që paraqesin rrezik serioz për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve.

## Kreu 6

### DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

#### Kompetenca

##### Neni 29

(1) Për kundërvajtjet nga neni 30 paragrafi (1) pikat 1), 2) dhe 5), paragrafët (2), (3), (4), (5) dhe (6) dhe neni 31 të këtij ligji, procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksione kundërvajtëse shqipton gjykata kundërvajtëse.

(2) Për kundërvajtjet e parapara me nenin 30 paragrafi (1) pikat 3), 4), 6), 7) dhe 8) të këtij ligji, procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksione kundërvajtëse shqipton Ministria e Ekonomisë, përkatësisht ministritë kompetente për sferën adekuate, nëpërmjet Komisionit për vendimmarrje për kundërvajtjen (në tekstin e mëtutjeshëm: organi kundërvajtës).

#### Kundërvajtje dhe gjoba

##### Neni 30

Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, i cili është mikro tregtar nëse:

- 1) plason në treg prodhime të rrezikshme (neni 5);
- 2) prodhon, importon, eksporton ose plason në treg prodhime mashtruese (neni 7);
- 3) nuk ua siguron konsumatorëve të gjitha informatat adekuate për rrezikun nga prodhimi (neni 9 paragrafi (1));
- 4) nuk ndërmerr masa për vlerësim përkatësisht përcaktim të rrezikut (neni 9 paragrafi (4) pika 1 dhe 2);
- 5) plason prodhime për të cilat e ka ditur ose është dashur të dijë se nuk janë në pajtim me kërkesat për siguri të përgjithshme të prodhimeve (neni 10 paragrafi (2));
- 6) nuk dorëzon informata për rreziqet nga prodhimi, nuk e ruan dokumentacionin për përcaktimin e prejardhjes së prodhimeve dhe nuk bashkëpunon në masat e ndërmarra nga prodhuesit dhe nga organet shtetërore kompetente (neni 10 paragrafi (3));
- 7) nuk dorëzon njoftim për rreziqet nga prodhimi me përmbajtje, në mënyrë, procedurë dhe në afatet e përcaktuara me rregull (neni 11 paragrafi (1) dhe (2)) dhe
- 8) nuk bashkëpunon me organet inspektuese kompetente në veprimet që ndërmerren me qëllim që të mënjanohej rreziqet (neni 12 paragrafi (1));

(2) Gjobë në shumë prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik i cili është tregtar i vogël për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik i cili është tregtar i mesëm për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 5.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik i cili është tregtar i madh për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Gjobë në shumë prej 100 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik ose tregtarit-individ për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

##### Neni 31

(1) Gjobë në shumë prej 1.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, i cili është mikro tregtar, nëse nuk i ndërmerr masat për parandalimin e rrezikut të inspektoratit kompetent në afatin e përcaktuar me aktvendim (neni 18 paragrafi (1)).

(2) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 6.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili është tregtar i vogël për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 3.000 deri 9.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik i cili është tregtar i mesëm për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 6.000 deri 20.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik i cili është tregtar i madh për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Gjobë në shumë prej 250 deri 750 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik ose tregtarit-individ për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

### **Sanksione dhe masa të veçanta kundërvajtëse**

#### **Neni 32**

(1) Për kundërvajtjet nga neni 30 i këtij ligji, të cilat janë bërë me qëllim që kryerësi për vete ose për person tjetër të përfitojë dobi pronësore ose kundërvajtja është bërë nga grupi i organizuar i personave ose gjatë vitit kalendarik kryerësi e përsërit kundërvajtjen, gjykata kompetente mund të shqiptojë gjobë në lartësi të dyfishtë nga gjoba e paraparë me nenin 30 të këtij ligji.

(2) Për kundërvajtjet nga neni 31 i këtij ligji, të cilat janë bërë me qëllim që kryerësi për vete ose për person tjetër të përfitojë dobi pronësore ose kundërvajtja është bërë nga grupi i organizuar i personave ose gjatë vitit kalendarik kryerësi e përsërit kundërvajtjen, gjykata kompetente mund të shqiptojë gjobë në lartësi të dyfishtë nga gjoba e paraparë me nenin 31 të këtij ligji.

(3) Për kundërvajtjet nga nenet 30 dhe 31 të këtij ligji, kur ekziston rrezik kundërvajtja të përsëritet, personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim i përkohshëm për kryerjen e veprimit të veçantë në kohëzgjatje prej tre muajsh deri në dy vjet.

(4) Për kundërvajtjet nga neni 30 i këtij ligji, personit përgjegjës në personin juridik, personit fizik, përkatësisht tregtarit-individ do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej tre muajsh deri në një vit.

(5) Kur me kundërvajtjet nga nenet 30 dhe 31 të këtij ligji, kryerësi do të fitojë dobi pronësore, gjykata do t'ia marrë edhe dobinë pronësore e cila është realizuar me bërjen e kundërvajtjes.

### **Procedura për lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse**

#### **Neni 33**

(1) Për kundërvajtjet nga nenet 30 dhe 31 të këtij ligji, inspektori kompetent do të zbatojë procedurë për lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(2) Inspektorati kompetent mban evidencë për urdhërpagesat e lëshuara kundërvajtëse dhe për rezultatin e procedurave për lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse.

#### **Kreu 7**

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Afate për miratimin e akteve**

#### **Neni 34**

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Zbatim i prolonguar**

Neni 35

Dispozitat nga neni 11 paragrafi (3), neni 13 paragrafi (6), neni 15, neni 16, neni 27 paragrafi (2) dhe neni 28 do të zbatohen pas aderimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.

### **Hyrja në fuqi**

Neni 36

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.